

## **SUNDIMI I LIGJIT DHE GJYKIMI I DREJTË**

---

### **SUNDIMI I LIGJIT NË SHOQËRITË DEMOKRATIKE**

#### **GJYKIMI I DREJTË – ELEMENT THEMELOR I SUNDIMIT TË LIGJIT**

#### **ELEMENTET E GJYKIMIT TË DREJTË**

---

*>>Sundimi i ligjit është më shumë se vetëm përdorimi formal i instrumenteve ligjore - gjithashtu është sundim i drejtësisë dhe mbrojtje e të gjithë anëtarëve nga përdorimi i tepërt i dhunës shtetëore.<<*

### **KOMISIONI NDËRKOMBËTAR I JURISTËVE**

#### **TREGIMI ILUSTRUES**

*Në mëngjesin e hershëm të 16 dhjetorit 1988, Z.A ishte arrestuar në shtëpinë e tij për tentim sulmi me bombë ndaj personelit ushtarak, sipas Kapitullit 12 të Ligjit Britanik për Parandalimin e Terrorizmit. Z.A u dërgua në stacionin policor në Kastelreg (Castlereagh). Ai tregon se menjëherë pas arritjes ka kërkuar ta shohë avokatin e tij. Një gjë e tillë i është mohuar Z. A. Arrestimi i Z.A ishte bërë në pajtim me Urdhërin për Prova Penale të vitit 1988. Z.A, duke qenë i panjohur me këtë ligj të ri, kërkoi përsëri të konsultohet me mbrojtësin e tij dhe kjo kërkesë iu refuzua. Gjatë asaj dite, Z.A ishte marrë pesë herë në pyetje nga dy ekipe të përbëra me nga dy detektivë. Herën e fundit u intervistua në mesnatë.*

*Më 17 dhjetor të vitit 1988, Z.A u ankua te një mjek për keqtrajtimin që i ishte bërë gjatë dy intervistave nga dita e kaluar. Mjeku mori shënime në fletoren e tij lidhur me pretendimet e Z.A, se gjatë intervistës së dytë dhe të tretë, ai ishte rrahur vazhdimisht me shuplaka dhe ishte goditur mbas kokës, si dhe ishte goditur disa herë në stomak.*

*Pastaj, intervista e gjashtë, e shtatë dhe e tetë me Z.A ishin zhvilluar gjithashtu atë ditë. Gjatë intervistës së gjashtë Z.A ndërpreu heshtjen e tij dhe ofroi përgjigje të detajuara lidhur me pyetjet e shumta, me ç' rast pranoi edhe pjesëmarrjen e tij në organizimin dhe planifikimin e sulmit me bombë. Gjatë intervistës së shtatë, Z.A nënshkruajti një deklaratë të gjatë, në të cilën në mënyrë mjaft të detajuar përshkruhej involvimi i tij në komplotin e vënies dhe shpërthimit të bombës.*

*Me 18 dhjetor 1988, Z.A iu lejua të konsultohet me avokatin e tij, me ç'rast ai mori shënime për pretendimet e Z.A lidhur me keqtrajtimin e tij. Avokati vendosi që të mos ia paraqet këto ankesa policisë.*

*Me 19 dhjetor 1988, Z.A së bashku me të tjerët u akuzua nga Gjykata e magjistratit të Belfastit, për komplot në shkaktimin e eksplozimit, posedim të qëllimshëm të eksplozivit, komplot për vrasje, si dhe anëtarësim në Ushtrinë Republikane të Irlandës (Irish Republican Army – IRA).*

*Me 17 dhjetor 1990, në Gjykatën mbretërore të Belfastit filloi gjykimi ndaj Z.A dhe të bashkakuzuarve të tjerë, nga një gjyqtar i vetëm dhe pa juri. Z.A u deklarua i pafajshëm. Prokuroria e bazonte rastin në pranimin e Z.A që kishte bërë gjatë intervistës, e sidomos në deklaratën e nënshkruar nga ai. Z.A nuk kishte dhënë ndonjë provë tjetër në vijim të gjykimit. Sidoqoftë, gjyqtari dënoi Z.A me njëzet vjet burgim.*

*(Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR) e vendosi këtë rast më 6 qershor të vitit 2000. ECHR-ja vendosi se gjatë gjykimit ishte shkelur e drejta për gjykim të drejtë, ashtu siç parashihet me Nenin 6 të Konvntës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.)*

**BURIMI:** MARRË NGA RASTI MAGEE V. THE UNITED KINGDOM, ECHR, 6

QERSHOR 2000; GJINDET NË:

[HTTP://HUDOC.ECHR.COE.INT/HUDOC2DOC2/HEJUD/200207/MAGEE.BTJ.DOC](http://HUDOC.ECHR.COE.INT/HUDOC2DOC2/HEJUD/200207/MAGEE.BTJ.DOC)

## **PYETJET PËR DISKUTIM**



1. Cilat arsye mendoni se ekzistonin për një trajtim të tillë të Z.A? Cilat të drejta janë shkelur në këtë rast?
2. Çka mendoni se duhet bërë për të parandaluar veprimet e tilla?
3. A keni njohuri për sistemet mbrojtëse të cilat tashmë ekzistojnë?

## **E DOMOSDOSHME TË DIHET**



### **1. HYRJE**

Paramendojeni veten të ulur në sallën e gjyqit dhe duke mos ditur arsyen pse ndodheni aty. Kur gjyqtari fillon të lexojë me zë akuzën ndaj jush, bëheni edhe më konfuz, pasi që

krimi për të cilin akuzoheni nuk ishte konsideruar kurrë nuk më parë i ndaluar me ligj, dhe nuk gjendet si i tillë edhe në legjislacionin aktual. Askush nuk u përgjigjet pyetjeve tuaja, ndiheni plotësisht të paaftë për t'u mbrojtur dhe madje nuk keni qasje në avokat mbrojtës. Ndërkaq, bëhet edhe më keq kur fillon dëgjimi i dëshmitarëve dhe ju e shihni se së paku njëri nga ata nuk e flet gjuhën të cilën ju e kuptoni, kurse aty nuk ka përkthyes. Gjatë gjyqimit, nga gjyqtari mësoni se kjo ishte seanca e dytë me radhë dhe se e para ishte mbajtur pa prezencën tënde. Dhe, deri sa gjykimi vazhdon, gjithnjë e më shumë bëhet e qartë se të gjithë janë të bindur në fajësinë tënde dhe se në realitet e vetmja dilemë është se çfarë do të jetë dënimi . . .

Ky shembull tregon çka mund të ndodhë kur shkilen të drejtat për **gjykim të drejtë**. E drejta për gjykim të drejtë, e cila njihet gjithashtu si 'udhëheqje e drejtë e drejtësisë', paraqet gurthemelin e një shoqërie demokratike drejt zbatimit të 'sundimit të ligjit'.



### **Sundimi i Ligjit**

Sundimi i ligjit prek fusha të ndryshme të politikave dhe në vete përfshin çështje politike, kushtetuese, ligjore, si dhe çështje të të drejtave të njeriut. Çdo shoqëri demokratike që synon nxitjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si parim fundamental duhet ta njohë supremacinë e ligjit.



Moduli për Demokracinë.

Edhe pse sundimi i ligjit është gurthemel i shoqërisë demokratike, nuk ekziston një konsensus i plotë mbi të atë se cilat janë të gjitha elementet e tij përbërëse. Sidoqoftë, më se kontravers duket fakti se, qytetarët mbrohen nga veprimet arbitrare të autoriteve publike, vetëm atëherë kur të drejtat e tyre janë të parapara me ligj. Ky ligj duhet t'i bëhet publikut i njohur, të aplikohet njësoj për të gjithë dhe të zbatohet në mënyrë efektive. Është evidente se ushtrimi i pushtetit shtetëror duhet të bazohet në ligje të cilat janë nxjerrë në pajtim me kushtetutën dhe kanë për qëllim sigurimi e lirisë, drejtësisë dhe sigurisë juridike.

*Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut në Vjenë, e vitit 1993, riafirmoi lidhjen e pandashme mes parimit të sundimit të ligjit, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të*

njeriut. Gjatë konferencës u pranua se mungesa e sundimit të ligjit është një nga pengesat më të mëdha për implementimin e të drejtave të njeriut. Sundimi i ligjit siguron bazën për menaxhim të drejtë mes dhe ndër popuj dhe në këtë mënyrë, përkrah diversitetin. Sundimi i ligjit është shtyllë e procesit demokratik. Gjithashtu, sundimi i ligjit siguron **përgjegjësinë** dhe kontrollin ligjor ndaj udhëheqësve.

>> *Përcaktimi im në punën time për sundimin e ligjit si një temë e gjithanshme nuk është aspak për shkak të universalitetit të saj. Ajo është po ashtu baza më e fuqishme e sigurisë*<<

**SERGIO VIEIRA DE MELLO**, KOMESAR I OKB-së PËR TË DREJTAT E NJERIUT, 2003

### **Zhvillimi historik i sundimit të ligjit**

Parimi i sundimit të ligjit i ka rrënjët e tij qysh në Anglinë mesjetare. Që në vitin 1066, Uilliam Pushtuesi (William the Conqueror) kishte vendosur një pushtet qendror. Edhe pse mbreti e vuri në jetë pushtetin qendror qeveritar, legjislativ dhe gjyqësor, ai vetvetiu nuk qëndroi mbi ligjin – ishte ligji ai që e bëri atë mbret. Nga kuptimi i tillë, gjykatat e së drejtës zakonore dhe parlamenti së bashku me feudalët, forcuan ndikimin e tyre në sistemin vendor, duke ndërtuar kështu monarkinë e parë parlamentare në Evropë. Bazat e zhvillimit të sundimit të ligjit ishin, *Magna Charta Libertatum (1215)* e cila u ofronte feudalëve disa të drejta dhe *Habeas Corpus Act (1679)* i cili u jepte njerëzve në arrest të drejtën e pamohueshme për t'u njoftuar për arsyet e kufizimit të lirisë së tyre.

Në kontinentin e Evropës, parimi i sundimit të ligjit e fitoi rëndësinë e tij kundër prejardhjes së revolucioneve popullore gjatë shekullit XVII dhe XVIII. Sot, parimi i sundimit të ligjit është parim bazë i institucioneve vendore dhe regjionale në gjithë botën.



### **Gjykimi i drejtë si element kryesor i sundimi të ligjit**

Sundimi i ligjit, në radhë të parë do të thotë ekzistimi i ligjeve të njohura për popullin dhe ekzistimi i ligjeve jodiskriminuese. Vetëm ekzistimi i thjeshtë i tyre nuk do të thotë asgjë, nëse ato ligje nuk zbatohen. Prandaj, shteti duhet të krijojë institucione që e mbikëqyrin sistemin ligjor, duke përfshirë gjykata, prokurorë dhe polici. Ashtu siç parashihet me konventa universale dhe regjionae për të drejtat e njeriut, siç janë Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut,

Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut dhe Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve, këto institucione vetvetiu janë të lidhura për të garantuar të drejtat e njeriut.

Me rëndësi është të theksohet se, ICCPR bën një referim të posaçëm të të **miturve**. ICCPR-ja potencon se në rastin e të miturve, procedura duhet të marrë parasysh moshën e të miturve dhe vullnetin për ta përkrahur rehabilitimin e tyre. Kjo nënkupton se shteti duhet të hartojë legjislacionin për çështjet relevante, siç janë mosha minimale në të cilën mund të akuzohet i mituri për vepër penale, moshën maksimale deri në të cilën një person mund të konsiderohet i mitur, ekzistimin e procedurave dhe gjyqeve të veçanta, ligje për zhvillimin e procedurës ndaj të miturve dhe që gjitha këto dispozita ligjore për të miturit duhet të marrin në konsideratë “*vullnetin për të përkrahur rehabilitimin e tyre*”.

Gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 2002, një seri e vrasjeve ka terrorizuar Uashington DC. Brenda një muaji, dhjetë njerëz u vranë dhe tre të tjerë u plagosën pa asnjë arsye nga një snajperist. Me 24 tetor, policia arrestoi dy njerëz: 42 vjeçarin Xhon Allen Muhamed (John Allen Muhammad) dhe shoqëruesin e tij 17 vjeçar Xhon Li Mallvo (John Lee Malvo). Ky i dyti, edhe pse i mitur, tani është duke u ndeshur me procedurë gjyqësore në Virxhinia, dhe mund të dënohet edhe me vdekje. Ky rast ka nxitur debat publik në SHBA, nëse është e justifikueshme të shqiptohet dënimit me vdekje ndaj një 17 vjeçari.

### **Sundimi i ligjit, gjykimi i drejtë dhe siguria njerëzore**

Siguria njerëzore nuk mund të realizohet pa sundimin e ligjit dhe pa gjykimin e drejtë. Parimi i sundimit të ligjit dhe i gjykimit të drejtë, i kontribuon sigurisë personale të njeriut, ashtu siç garantojnë se askush nuk do të persekutohet ose arrestohet në mënyrë arbitrare, gjithkush ka të drejtë për dëgjim të drejtë dhe gjyqtar të pavarur e të paanshëm. Procedurat e rregullta gjyqësore sjellin drejtësinë dhe besimin e qytetarëve brenda një jurisdiksioni të caktuar.

Për më tepër, një sistem gjyqësor i fortë ndihmon të mbajë krimin dhe korrupsionit në nivele të ulëta dhe, në këtë mënyrë, i kontribuon lirisë nga frika. Në situata të pasluftës si p.sh. ajo Bosnjë dhe Hercegovinës, është e rëndësishme në veçanti të rivendoset sundimi

i ligjit dhe i së drejtës për gjykim të drejtë, me qëllim që të përmirësohet siguria njerëzore përmes sigurisë ligjore, administrimit të gjyqësisë dhe qeverisjes së mirë. Këto janë mjete me anë të së cilave qytetarët kthejnë besimin ndaj shtetit dhe autoriteteve të tij.

Sa i përket mirëbesimit ekonomik dhe zhvillimit, sigurimi i investimeve varet fuqishëm nga administrata funksionale dhe sistemi gjyqësor. Prandaj, rritja ekonomike dhe mirëqenia sociale, siç janë siguria sociale dhe ajo ekonomike, të cilat korrespondojnë me lirinë nga skamja, gjithashtu janë të varura nga sundimi i ligjit dhe nga gjykimi i drejtë.

## 2. DEFINIMI DHE PËRSHKRIMI I GJYKIMIT TË DREJTË



Çka është gjykim i drejtë? E drejta për një gjykim të drejtë lidhet me administrimin e gjyqësisë për të dy llojet e konteksteve, ato civile dhe penale. Fillimisht është e rëndësishme të kuptohet se administrimi i gjyqësisë ka dy aspekte, atë institucional (p.sh. pavarësia dhe paanshmëria e organeve gjyqësore) dhe procedural (p.sh. rregullësia e dëgjimit). Parimi i gjyqësorisë përkrah një seri të drejtave individuale, duke siguruar kështu administrimin e mirë të gjyqësisë që nga momenti i dyshimit deri tek ekzekutimi i dënimit.

### **Standardet minimale të drejtave të akuzuarit janë:**

1. Të gjithë personat janë të barabartë para gjykatave dhe organeve gjyqësore, dhe të gjithë kanë të drejtën e barazisë së plotë në garancitë minimale për gjykim të drejtë;
2. Çdonjëri ka të drejtën e qasjes së lirë ndaj masve gjyqësore të drejta dhe efektive;
3. Organi gjyqësor të jetë i plotë, pavarur, paanshëm dhe i themeluar në bazë të ligjit;
4. Çdonjëri ka të drejtën e dëgjimit të drejtë dhe publik; prandaj, publiku mund të përjashtohet vetëm në rastet specifike;
5. Çdo person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm deri sa fajësia e tij provohet ligjërisht;
6. Çdonjëri ka të drejtë të gjykohet pa vonesë të tepruar;
7. Çdokush ka të drejtë të gjykohet në praninë e vet. I akuzuari ka të drejtë të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; në qoftë se nuk ka mbrojtje ai duhet të informohet për këtë të drejtë, kurdoherë që e kërkon interesi i

drejtësisë, atij duhet ti caktohet një mbrojtje detyruesisht pa shpenzime nëse ai nuk ka mjete për ta paguar;

8. I akuzuari ka të drejtë të pyesë ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të marrë pjesë dhe të ekzaminojë dëshmitarët nën emrin e tij.;
9. I akuzuari ka të drejtë të ketë ndihmën falas të një përkthyesi, në qoftë se nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret në gjyq;
10. Askush nuk mund të dënohet për veprime ose mosveprime të cilat nuk përbëjnë shkelje sipas të drejtës kombëtare ose ndërkombëtare në kohën kur janë kryer. Nuk mundet të jepet një dënim më i rëndë se ai që mund të zbatohet në kohën kur është kryer shkelja penale.

Dispozitat ndërkombëtare, sikurse Neni 14 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike për të drejtën në gjykim të drejtë, aplikohen në gjitha gjykatat dhe organet tjera gjyqësore, pa marrë parasysh se a janë ato të rregullta ose të specializuara. Në shumë shtete ekzistojnë **gjykata ushtarake ose të veçanta**, të cilat gjykojnë edhe civilët e thjeshtë. Shpesh, si arsytim për themelimin e gjykatave të tilla është mundësimi i aplikimit të procedurave të veçanta, që nuk janë në pajtim me standardet normale të drejtësisë. Deri sa Pakti nuk ndalon ekzistimin e kategorisë së gjykatave të tilla, megjithatë, sipas kushteve që i ka përcaktuar, në mënyrë të qartë thekson se gjykimi i civilëve në gjykata të tilla duhet bëhet vetëm përjashtimisht dhe vetëm nën kushte të cilat garantojnë në tërësi masat e theksuara në Nenin 14.

### **Dispozitat për Gjykim të Drejtë**

- 1948 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Neni 11
- 1950 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 6
- 1966 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 14
- 1969 Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut
- 1985 Parimet Themelore të OKB-së për Gjyqësi të Pavarur,
- 1985 Rregullat Standarde Minimale të OKB-së për Administrim të Gjyqësisë së të Miturve
- 1986 Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve, Neni 7

- 1990 Parimet Themelore të OKB-së për Rolin e Avokatëve
- 1990 Udhëzimet e OKB-së për Rolin e Prokurorëve



### **Barazia para Ligjit dhe para Gjykatës**

Garantimi i barazisë është një ndër parimet kryesore të syndimit të ligjit. Kjo ndalon ligjet e karakterit diskriminues dhe përfshin të drejtën për qasje të barabartë ndaj gjykatave dhe të drejtën për trajtim të barabartë nga gjykatat. Aspekti më i rëndësishëm praktik i këtij parimi është **barazia e armëve**, që përfshin idenë se secila palë në procedurë duhet të ketë mundësi të barabarta për të prezantuar rastin dhe se asnjëra palë nuk duhet të gëzojë ndonjë përparësi substanciale ndaj kundërshtarit të vet.

Një aspekt tjetër i trajtimit të barabartë nga gjykata, është ai se çdo i akuzuar ka të drejtë të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe pa kurfarë diskriminimi si të gjithë të akuzuarit e tjerë. Sidoqoftë, në këtë kontekst duhet kujtuar se trajtimi i barabartë nuk do të thotë trajtim identik. Do të thotë se kur rrethanat objektive janë të ngjashme, trajtimi nga ana e sistemit administrativ dhe gjyqësor duhet të jetë i ngjashëm, por kur faktet janë të ndryshme, atëherë parimi i barazisë kërkon trajtim tjetër.

### **Qasja në mjete gjyqësore efektive dhe të drejta**

Standardet e gjykimit të drejtë përfshijnë një numër të elementeve që përbëjnë administrimin e drejtë të gjyqësisë. Këto elemente deri në një masë mund të shihen si përkufizime të karakteristikave të përgjithshme të institucioneve gjyqësore dhe si skicime të parametrave të gjerë, përmes të cilëve në fund mund të gjykohet mbi rregullsitë e procedurave. Sidoqoftë, para se të arrihet deri në pikën ku mund të bëhen vlerësime të tilla, individit duhet t'i oforhet mundësia që të dëgjohet rasti i tij ose i saj.

Një parim tjetër i rëndësishëm i sundimit të ligjit në rastet kur kemi pretendim për shkeljen e të drejtës për qasje të njëjtë ndaj gjykatës, është se shteti nuk mund të kufizojë ose eliminojë shqyrtimin gjyqësor në fusha të caktuara, ose ndaj një klase të caktuar të individëve.

Qasja e lirë ndaj gjykatave nuk duhet të garantohet vetëm në kontekst të proceseve civile. Kjo është po aq e rëndësishme edhe për zhvillimin e rregullt të rasteve penale, pasi që

ofron mbrojtje kundër dënimeve që nuk përmbush kriteret për zhvillim të gjykimit të drejtë nga trupi gjyqësor.



### **Pavarësia dhe paanshmëria**

Roli i gjykatave të pavarura dhe të paanshme është një nga elementet themelore të funksionimit të sundimit të ligjit në kuadër të një sistemi juridik. Sipas parimit të ndarjes së pushteteve, pushteti gjyqësor duhet të jetë plotësisht i ndarë nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv.

Në vitin 2001, Amnesty International raportoi për një rast në Egjipt, ku 94 civilë ishin gjykuar nga një gjykatë ushtarake, për shkak të pretendimit për ekzistimin e lidhjes së tyre me një grup të armatosur islamist. Ata ishin torturuar dhe ishin mbajtur në burg të mbyllur, pa mundësi komunikimi me të tjerët. Për më tepër, atyre u ishte kufizuar edhe e drejta e gjykimit të drejtë, pasi që nuk ishte siguruar paanshmëria dhe pavarësia e gjykatave ushtarake nga ekzekutivi.

Pavarësia e gjyqtarëve është një nga shtyllat e gjyqësisë së pavarur. Nëse gjyqtarët mund të shkarkohen në çdo moment nga qeveria ose autoritetet e tjera, atëherë nuk mund të sigurohet pavarësia e tyre institucionale. Për më tepër, nëse edhe vetë gjyqet ose gjyqtarët janë nën kontrollin ose influencën e entiteteve jogjyqësore, atëherë nuk mund të sigurohet kurrfarë gjykimi i drejtë. Shembuj të kontrolleve të tilla janë: kushtet e pagesës së gjyqtarëve, mundësia e degëve të tjera të pushtetit për t'u dhënë instruksione gjykatave, ose kërcënimet për transferin e gjyqtarëve në pozita të tjera, nëse vendimet e tyre nuk janë në pajtim me instruksionet dhe të priturat e caktuara.

Vendimet e gjykatës nuk mund të ndërrohen nga autoritetet jogjyqësore, përveç në rastet kur me kushtetutë njihet e drejta e amnestisë, që zakonisht dhurohet nga kryetari i shtetit.

Normat për gjykim të drejtë nuk kërkojnë ndonjë strukturë të veçantë të përbërjes së trupit gjykues, i cili mund të përbëhet vetëm nga gjyqtarë profesionalë, nga panele të kombinuara të gjyqtarëve profesionalë dhe atyre laikë, ose kombinime të tjera. Sidoqoftë, ekzistojnë standarde ndërkombëtare për pavarësinë e gjyqësisë, të cilat gjithashtu përfshijnë edhe dispozita për emërimin e gjyqtarëve. Në anën tjetër, asnjë instrument ndërkombëtar nuk kërkon gjykim me juri. Sidoqoftë, në ato vende të cilat aplikojnë

sistemin e gjykimit me juri, kërkesat e pavarësisë dhe paanshmërisë, gjithashtu, aplikohen edhe për juritë.

### **Dëgjimi publik**

Me qëllim që të nxitet besimi ndaj administratës së gjyqësisë dhe të sigurohet dëgjimi i drejtë i palëve, procedurat duhet të jenë të hapura për publikun e gjerë. Sipas maksimës së njohur e cila thotë se drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet, por duhet të shihet se si bëhet, publiku ka të drejtë të dijë se si bëhet drejtësia dhe çfarë vendimesh merren. Dëgjimi publik, nënkupton dëgjimet e prezantimeve gojore për bazat e rastit, të cilat duhet të jenë publike dhe të cilat mund t'i përcjellë publiku, dhe shtypi. Për këtë arsye, gjykatat duhet ta bëjnë publike kohën dhe vendin e dëgjimeve të prezantimeve gojore. Parimi i publicitetit duhet të respektohet në tërësi, përveç nëse ekziston ndonjë arsye që lejon përjashtimin e publikut.

Arsyet për **kufizime** janë theksuar në vetë instrumentet ndërkombëtare, dhe mund të jenë, morali (p.sh. dëgjimi që ka të bëjë me veprat seksuale), rendi publik (kryesisht në dhomat e gjykatave) dhe siguria kombëtare në shoqëritë demokratike, ose kur këtë e kërkon interesi jetësor i palëve, si dhe në rrethana të posaçme, ku publiciteti mund të kërcënojë nxjerrjen e një aktgjykimi të drejtë dhe adekuat.

Sidoqoftë, edhe në ato raste kur publiku është përjashtuar nga gjykimi, përveç në disa raste të përjashtimit strikt, siç janë interesat e të miturve ose marrëdhëniet familjare, **aktgjykimi duhet të bëhet publik.**



### **E drejta e prezumimit të pafajësisë**

E drejta për t'u prezumuar i pafajshëm do të thotë se secili i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të prezumohet i pafajshëm dhe duhet të trajtohet si i pafajshëm deri, dhe vetëm atëherë, kur në bazë të ligjit dhe në gjykim të drejtë, provohet se ai, ose ajo është fajtor. Ky parim aplikohet ndaj personave që nga momenti i dyshimit dhe përfundon pas ankesës së fundit, atëherë kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm. Kështu që, në rastet penale, prokuroria duhet ta vërtetojë fajësinë e personit të akuzuar dhe i akuzuari nuk bën të shpallet fajtor edhe nëse në këto raste ekziston dyshim i bazuar.

E drejta e prezumimit të pafajësisë kërkon nga gjyqtarët dhe juritë të përmbahen nga paragjykimi i çfarëdo rasti. Kjo, gjithashtu, aplikohet ndaj zyrtarëve të tjerë publik të cilët janë pjesë e procedurës. Sidoqoftë, duhet pasur parasysh se përderisa nuk deklarohet se një person është fajtor, nuk është shkelje e kësaj të drejte kur autoritetet informojnë publikun për zhvillimin e hetimeve dhe me këtë rast tregojnë emrin e atij personi.

E drejta për të heshtur ose e drejta për të mos u detyruar për të dëshmuar kundër vetes ose pranim të fajësisë, gjithashtu bëjnë pjesë në kuadër të parimit për të drejtën e prezumimit të pafajësisë. E drejta për të heshtur, gjithashtu, kërkon që para se të zhvillohen hetimet nga ana e prokurorit, qetësia të mos merret në konsiderim gjatë përcaktimit të fajësisë ose pafajësisë. E drejta për të mos u detyruar për dëshmim kundër vetes dhe pranim të fajësisë nënkupton ndalimin e ushtrimit të çfarëdo forme të presionit.

### **E drejta për t'u gjykuar pa vonesë të tepruar**

Periodha kohore që parashihet me dispozita ligjore lidhur me vonesën e tepruar, përfshin jo vetëm kohën deri te fillimi i gjykimit, por totalin e gjatësisë së procesit në tërësi, përfshirë këtu edhe ankesat e mundshme nëpër instancat më të larta gjyqësore, deri te Gjykata Supreme ose ndonjë autoritet tjetër përfundimtar gjyqësor.

Se çka nënkuptohet me gjatësinë e kohës së arsyeshme ndryshon varësisht nga natyra e rastit në procedurë. Vlerësimi i asaj se çka mund të konsiderohet vonesë e tepruar varet nga rrethanat e rastit, siç janë kompleksiteti i rastit, sjellja e palëve, kërkesat e palës parashtruese dhe si drejtohet nga autoritetet.

Për më tepër, duhet pasur parasysh se në rastet penale e drejta për gjykim të drejtë, pa vonesë të tepruar, është gjithashtu e drejtë e viktimës. Parimi i përmendur i kësaj rregulle është shprehur shumë mirë në këtë frazë: *“drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar”*

### **E drejta për t'u mbrojtur vetë ose përmes përfaqësuesit ligjor dhe e drejta për të qenë i pranishëm gjatë gjykimit**

Çdo i akuzuar për një veprër penale ka të drejtë për t'u mbrojtur vetë ose përmes përfaqësuesit ligjor. E drejta për mbrojtës gjatë fazave paraprake të procedurave penale

është qartazi e lidhur me të drejtën për të qenë i mbrojtur gjatë gjyqimit. Në përgjithësi, dispozitat theksojnë se për përcaktimin e çdo aktakuze penale kundër ndonjë personi, ai ose ajo ka të drejtë *“të jetë i pranishëm gjatë procesit dhe të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; në qoftë se nuk ka mbrojtje, ai duhet të informohet për të dejtën e tij që të ketë një të tillë dhe kurdoherë që e kërkon interesi i drejtësisë, atij duhet t’i caktohet një mbrojtje detyruesisht pa shpenzime, nëse ai nuk ka mjete për ta pguar”* – Neni 14 (3d) ICCPR.

### **Përmbajtja e të drejtës për t’u mbrojtur vetë ose përmes përfaqësuesit ligjor dhe të drejtës për të qenë i pranishëm gjatë gjyqimit**

- e drejta për të qenë i pranishëm gjatë gjyqimit
- e drejta për të mbrojtur veten
- e drejta për ta zgjedhur vetë mbrojtësin
- për të qenë i informuar mbi të drejtën për mbrojtës dhe
- për të marrë ndihmë ligjore pa pagesë

Varësisht nga seriozitetit i dënimit të mundshëm, shteti nuk është i obliguar që për çdo rast të caktojë mbrojtës ligjor. Për shembull, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut ka vendosur se çdo personi të akuzuar për vepër penale për të cilën parashihet dënimi me vdekje, duhet t’i caktohet mbrojtësi. Sidoqoftë, një personi të akuzuar për tejkallim të shpejtësisë nuk është e domosdoshme që në llogari të shtetit t’i caktohet mbrojtësi. Sipas Gjykatës Interamerikane për të Drejtat e Njeriut, me qëllim të sigurimit të dëgjimit të drejtë, është e domosdoshme të caktohet mbrojtësi.

Kur duhet të caktohet mbrojtësi, duhet pasur parasysh se i akuzuari ka të drejtë në mbrojtës me përvojë, të aftë dhe efektiv. I/e akuzuari/a, gjithashtu ka të drejtë për komunikim të fshehtë me mbrojtësin e vet.

Edhe pse ekziston e drejta për të qenë i pranishëm gjatë gjyqimit, në raste të jashtëzakonshme dhe për shkaqe të arsyeshme, gjykimet mund të mbahen edhe në mungesë, por gjithnjë e më i domosdoshëm është duke u bërë vëzhgimi strikt i të drejtave të mbrojtjes.

## **E drejta për të kërkuar dhe pyetur dëshmitarët dhe për t'i sjellë në gjyq që të merren në pyetje**

Kjo dispozitë është hartuar për t'i garantuar të akuzuarit fuqi të njëjta me qëllim të sigurimit të prezencës së dëshmitarëve dhe marrjes së tyre në pyetje, si dhe marrjes në pyetje të çdo dëshmitari që është në dispozicion të prokurorisë. Kjo siguron që mbrojtja ta ketë mundësinë për t'i pyetur dëshmitarët të cilën do të japin prova dhe t'i sfidojnë ato prova që janë kundër të akuzuarit.

Ekzistojnë disa kufizime për ekzaminimin e dëshmitarëve të prokurorisë. Këto bazohen në sjelljet e të akuzuarit, kur dëshmitari me arsye frikësohet nga hakmarrja dhe në rastet kur dëshmitari nuk paraqitet fare.

## **E drejta për përkthyes pa pagesë**

Nëse personi nuk kupton ose nuk e flet gjuhën e cila përdoret në gjyq, ai ose ajo ka të drejtë për një përkthyes pa pagesë, duke përfshirë gjithashtu edhe përkthimin e dokumenteve. E drejta në përkthyes aplikohet për gjithë vendorët dhe të huajt që nuk janë mjaft të rrjedhshëm në gjuhën e gjyqit. E drejta për përkthyes mund të kërkohej nga i dyshuari ose i akuzuari që në momentin e marrjes në pyetje nga policia, gjyqtari hetues ose gjatë gjykimit. Gjatë procesit gjyqësor, përkthyesi përkthen gojarisht të akuzuarit dhe gjyqit.



### **Parimi *Nulla Poena Sine Lege***

Fjalja latine “*nulla poena sine lege*”, thjesht do të thotë se askush nuk mund të dënohet për vepra të cilat nuk kanë qenë të kundërligjshme në momentin e kryerjes, edhe pse që nga ajo kohë ligji ka ndryshuar. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë i aplikueshëm në kohën kur është kryer vepra penale. Ky i ashtuquajtur **joretroaktivitet** i ligjit, siguron që personi i cili jeton në pajtim me ligjin, nuk rrezikohet që papritmas të dënohet për ndonjë vepim i cili në fakt ka qenë i ligjshëm. Prandaj, aplikimi i parimit të joretroaktivitetit është i pazëvendësueshëm për realizimin e sigurisë ligjore.




### 3. PERSPEKTIVAT NDËRKULTURORE DHE ÇËSHTJET

#### KONTRAVERSE

Parimi i sundimit të ligjit është i pranuar gjerësisht. Sidoqoftë, nëse bëhen krahasime mes interpretimeve të ndryshme rreth përmbajtjes së sundimit të ligjit, mund të vërehen dallime të konsiderueshme kulturore mes shteteve të ndryshme. Dallimi më i theksuar është ai mes kuptimit amerikan dhe aziatik. Juristët amerikanë, tentojnë që sundimit të ligjit t’ia atribuojnë disa karakteristika të sistemit të tyre të drejtësisë, siç janë gjykimi me juri, të drejta më të mëdha për të akuzuarin dhe një ndarje të qartë mes pushteteve shtetërore, deri sa juristët aziatik theksojnë rëndësinë e aplikimit të rregullt dhe efektiv të ligjit pa nënshtrim të domosdoshëm të pushtetit shtetëror ndaj ligjit. Ky koncept më i ngushtë, i cili më mirë karakterizohet si *sundim*, se sa si *sundim i ligjit*, është ngushtë i lidhur me nocionin e “*demokracisë së stilit aziatik*”.

Në disa shtete, e drejta e kodifikuar islamike – **Sheriati** – i kufizon të drejtat e grave për gjykim të drejtë, pasi që ato nuk kanë të drejtë të barabartë me burrat në qasje ndaj gjykatave. Sidoqoftë, dallimet e bazuara në gjini janë të ndaluara me nenin 2 dhe 3 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR).

 Moduli për Liritë Fetare

Disa probleme me të cilat përballen shtetet gjatë tranzicionit në demokraci nuk mund të zbulohen përmes dallimeve kulturore. Shpesh ndodh që qytetarët të tregojnë pak konsideratë ndaj qeverive dhe sistemeve ligjore të cilat udhëhiqen në baza të lidhjeve miqësore dhe korrupsion, ku si rezultat i kësaj rriten krimi dhe dhuna civile. Poenta qendron në atë se, vendosja dhe funksionimi i mirë i sundimit të ligjit kërkon kohë dhe mjete financiare. Për më tepër, në ato vende ku liderët politik nuk shfaqin respekt ndaj vlerave demokratike dhe lirive civile, është shumë e vështirë të arrihet gjyqësia e pavarur. Sidoqoftë, në kohën e globalizmit ekonomik, është duke u rritur vazhdimisht kërkesa ndërkombëtare për stabilitet, përgjegjësi dhe transparencë, që mund të garantohen vetëm nga regjimet të cilat e respektojnë sundimin e ligjit.



### 4. ZBATIMI DHE MONITORIMI

#### Zbatimi

Mbrojtja e të drejtave të njeriut fillon që nga niveli familjar. Kështu që, implementimi i sundimit të ligjit varet nga vullneti i shtetit për të vendosur një sistem i cili garanton sundimin e ligjit dhe zhvillimin e procedurave të drejta gjyqësore. Shtetet, duhet që përveç vendosjes të bëjnë edhe mbajtjen e **infrastrukturës institucionale** të nevojshme për administrim të drejtë të gjyqësisë, si dhe të promulgojnë dhe implementojnë ligjet dhe rregulloret, të cilat garantojnë procedura të drejta dhe të barabarta.

Koncepti i sundimit të ligjit është i lidhur ngushtë me idenë e demokracisë, pranimin e lirive civile dhe politike, domosdoshmërinë e zhvillimit të ekonomisë së tregut, prandaj edhe implemtimi i tij varet nga realizimi i këtyre vlerave. Raste të ndryshme të studiuara në shtetet e tranzicionit tregojnë se vendosja e sundimit të ligjit dështon, nëse liderët politik nuk tregojnë vullnet për të respektuar parimet themelore të demokracisë dhe kështu mundësojnë korrupsionin dhe strukturat e krimit të organizuar.

***Rasti i Shqipërisë:*** tranzicioni i trazuar nga forma e pushtetit të centralizuar, në një ekonomi të tregut të hapur, ka shkaktuar probleme mjaft të rënda. Edhe pse faza e parë e tranzicionit politik dhe ekonomik kishte dhënë shpresa për optimizëm, si pasojë e sistemit të dobët ekzekutiv dhe gjyqësor, shumë shpejt fituan ndikim të madh organizata të ndryshme kriminale vendore dhe ndërkombëtare. Ata themeluan një skemë financiare piramidale, të cilat plaçkitën kursimet e mëse 75% të popullsisë, dhe në vitin 1997 e sollën vendin afër kolapsit të tërësishëm.

Forcimi i sundimit të ligjit përmes sistemit efektiv të kontrollit dhe balansit, si një rregull e përgjithshme, duket si rruga e vetme për luftimin e korrupsionit, ndalimin e liderëve të rinj të zgjedhur që të marrin vese autoritative dhe për të nxitur respektimin e të drejtave të njeriut. Por, si është e mundur që në realitet të implemetohen gjitha këto? Tri hapa janë të domodoshëm. Së pari, ligjet ekzistuese duhet të rishqyrtohen dhe nëse eventualisht nuk është bërë më herët, të kodifikohen. Së dyti, duhet forcuar institucionet që garantojnë administrimin e drejtë të gjyqësisë, p.sh përmes trajnimit të gjyqtarëve. Dhe së fundi, dhe që sigurisht është hapi më i vështirë për ta implementuar, duhet të rritet respektimi i qeverisë ndaj ligjit– kryesisht për ta siguruar pavarësinë e gjyqësisë.

Ekzistojnë trupa këshillues siç është Komisioni i Venedikut i Këshillit të Evropës, i cili ndihmon ose monitoron veprimet e qeverive dhe që është themeluar për forcimin e sundimit të ligjit dhe organizatave profesionale të gjyqtarëve.

### **Monitorimi**

Në shumë shtete, dispozitat për të drejtat themelore të njeriut janë të përfshira në kushtetuta. Zakonisht, në rastet ku pretendohet se janë shkelur këto të drejta, kushtetutat gjithashtu ofrojnë mundësinë për t'u thirrur në këto dispozita për të drejtat e njeriut. Ndërsa në nivel ndërkombëtar, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, janë nënshkruar marrëveshje të ndryshme për të drejtat e njeriut. Kur një shtet bëhet palë e një marrëveshje të tillë, ai është i detyruar të garantojë dhe implementojë këto dispozita në nivel vendor. Kjo varet nga forma se si është i organizuar rendi ligjor i vendit.

Disa marrëveshje për të drejtat e njeriut, siç është Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), me qëllim të monitorimit të implementimit dhe garantimit të dispozitave për të drejtat e njeriut, mundësojnë edhe mekanizma mbikëqyrës. Ky mekanizëm përbëhet nga **sistemi i raportimit**, ku shtetet palë janë të obliguara që trupit ndërkombëtar monitorues t'i raportojnë në perioda të rregullta kohore për mënyrën se si janë duke implementuar dispozitat e marrëveshjes. Për shembull, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, komenton mënyrën se si shtetet kanë përmbushur obligimet e tyre dhe gjithashtu mund t'u japë shteteve palë sugjerime dhe rekomandime për të përmirësuar implementimin e obligimeve të tyre për të drejtat e njeriut. Po ashtu, ky Komitet nxjerr **komente të përgjithshme** mbi interpretimin e ICCPR-it, siç është edhe Komenti i Përgjithshëm Nr. 13 mbi Nenin 14 të ICCPR-it, në vitin 1984.

Disa marrëveshje për të drejtat e njeriut, gjithashtu mundësojnë **mekanizma për ankesë**. Pasi që të shfrytëzohen të gjitha mjetet ligjore të vendit, një person mund të dërgojë “*komunikatë*”, duke pretenduar për shkelje të drejtave të garantuara me atë marrëveshje. Një mundësi e tillë ekziston sipas Protokollit Opcional të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Neni 34), Konventën Amerikane për të Drejtat e Njeriut (Neni 44) dhe Kartën Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve (Neni 55). Sipas këtyre marrëveshjeve, personat

mund të dërgojnë ankesat e tyre në Komitetin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komisionin Interamerikan për të Drejtat e Njeriut ose Komisionin Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve. Këta trupa mund t'i shqytojnë ankesat dhe në rast se gjejnë se ka ndodhur shkelja, shtetit të caktuar i rekomandohet që të marrë hapa të domosdoshëm për ta ndryshuar praktikën ose ligjin e tillë dhe t'i ofrojë viktimës dëmshpërblim.

Si pjesë e këtyre procedurave në fjalë, Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut ka emëruar **raportuesit special për ekzekutime të paligjshme, jashtëprocedurale dhe arbitrare** (1982), si dhe **raportuesit special për pavarësi të gjyqtarëve dhe avokatëve** (1994), kurse është themeluar edhe një grup punues për **arrestime arbitrare** (1991).

### **Ndërtimi i kulturës së respektimit të sundimit të ligjit në Kosovë**

Pas viteve të tëra të luftës dhe konfliktit të armatosur, gjendja në Kosovë po tregon shenja të qarta të avancimit të saj në rrugën drejt një shoqërie demokratike e cila respekton sundimin e ligjit. OSBE-ja duke ndihmuar rivendosjen e strukturave themelore të sistemit të gjyqësisë, është duke luajtur një rol të rëndësishëm në këtë proces. Ky proces është duke u rrezikuar nga fakti se vetëm ndërtimi i thjeshtë i institucioneve nuk do të mjaftojë, pasi që atje ekziston një mungesë e besimit në gjyqësi, si dhe kulturës së respektimit të sundimit të ligjit dhe po ashtu duhet të rivendoset kultura e të drejtave të njeriut në përgjithësi. Përveç përkrahjes së dhënë OJQ-ve, organizatave profesionale të gjyqtarëve, avokatëve dhe institucioneve të ngjashme, OSBE-ja ka ndihmuar themelimin e institucioneve të mëposhtme:

**Instituti Gjyqësor i Kosovë (KJI)** – KJI është themeluar për të ngritur njohuritë ligjore te gjyqtarët dhe prokurorët. Qëllimi i shumë seminareve trajnuese për standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të lidhura me aspektet e së drejtës penale dhe civile, kanë qëllim rifreskimin dhe ripërtirjen e njohurinë të tyre ligjore. Programi për arsimim juridik përbëhet gjithashtu nga vizitat studimore në vendet e regjionit për të nxitur dhe promovuar diskutimet lidhur me sfidat me të cilat përballen sistemet gjyqësore të shoqërive në tranzicion dhe gjetjen e zgjidhjeve të mundshme për përmirësimin e praktikës gjyqësore aktuale në Kosovë. Fokus i vazhdueshëm është trajnimi i trajnerëve

vendor dhe për këtë, një numër i anëtarëve të gjyqësisë kosovare kanë nxënë pranë KJI pozita si trajnues gjyqësor.

**Qendra Burimore për Mbrojtje Penale (CDRC)** – Institucioni më i ri i themeluar nga OSBE-ja fokusohet në përmirësimin e kapaciteve të avokatëve mbrojtës, ku përmes asistencës direkte në raste, hulumtimit dhe trajnimit ka qëllim që klientët të përfaqësohen në mënyrë sa më adekuate. CDRC-ja paraqet një balans ndaj përkrahjes, burimeve dhe ekspertizës së dhënë gjyqësisë dhe prokurorisë.

**Qendra Juridike e Kosovë (KLC)** – KLC-ja shërben si një institut kërkimor juridik i përkushtuar për zhvillimin e aftësive profesionale të jurisëve të ri e të talentuar të vendit. KLC-ja ka qenë aktive në asistimin e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës në shumë çështje, duke përfshirë reformimin e planprogramit, themelimin e bursave shkollore dhe programeve shkëmbyese, përmirësimin e bibliotekës, si dhe ofrimin e klinikave praktike ligjore. Një nga projektet më të rëndësishme të KLC-së ka qenë, përmbledhja e ligjeve të aplikueshme në Kosovë për përdorim të komunitetit ligjor në vend. Deri më tani, janë publikuar tri përmbledhje, e drejta penale, familjare dhe pronësore.

**BURIMI:** [HTTP://WWW.OSCE.ORG/KOSOVO/LAW](http://www.osce.org/kosovo/law)

## **E DOBISHME TË DIHET**



### **1. PRAKTIKA TË MIRA**

#### **Asistenca zhvillimore për vendosjen e sistemit gjyqësor funksional**

Shumë shtete perëndimore janë duke përkrahur reformat në fushën e sundimit të ligjit si pjesë të politikave të tyre për zhvillim. Për shembull, Rusia është ndihmuar nga SHBA-të me 58 milion dollarë si kredi nga Banka Botërore; janë përkrahur edhe projekte të tjera ndihmëse nga SHBA-të, Gjermania, Holanda, Danimarka, Bashkimi Evropian dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Disa shtete aziatike dhe të Amerikës Latine, gjithashtu kanë marrë asistencë të konsiderueshme financiare, deri sa është më e vogël përfshirja në Lindjen e Mesme dhe në Afrikë. U është dhënë përkrahje edhe projekteve

për forcimin e sundimit të ligjit në rindërtimin e shoqërive të pasluftës, si në Bosnjë e Hercegovinë dhe Kosovë.

### **Komisioni i Pavarur Gjyqësor në Bosnjë dhe Hercegovinë (IJC)**

Në vitin 2001, Përfaqësuesi i Lartë themeloi Komisionin Gjyqësor për Bosnjën dhe Hercegovinën. Mandati i këtij Komisioni është që përmes vlerësimit të institucioneve gjyqësore, të prokurorisë dhe institucioneve të qeverisë, pastaj koordinimit të reformave, asistimit të trupave vendore për trajnime gjyqësore dhe ofrimit të këshillave për të gjithë pjesëmarrësit, duke përfshirë shoqërinë civile, si dhe vetë Përfaqësuesin e Lartë, të promovojë sundimin e ligjit dhe reformën gjyqësore.

### **Rezoluta për Respektimin dhe Forcimin e Pavarësisë së Gjyqësisë (Afrikë)**

Në vitin 1996, **Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve** hartoi këtë rezolutë, duke pranuar kështu rëndësinë e një gjyqësie të pavarur, jo vetëm për shkak të ekuilibrit social, por gjithashtu për shkak të zhvillimit ekonomik. Kjo rezolutë thërret shtetet e Afrikës të ndërmarrin masa ligjore për sigurimin e pavarësisë gjyqësore dhe t'i ofrojnë gjyqësisë burime të mjaftueshme për përmbushjen e funksioneve të saj. Për shembull, në mënyrë që gjyqtarët të mund ta mbajnë pavarësinë e tyre, është shumë e rëndësishme që të kenë mjete të mjaftueshme për një jetë dinjitoze dhe kushte të pranueshme për punë. Për më tepër, shtetet duhet të përmbahen nga ndërmarrja e çfarëdo veprimi që do të kërcënonte drejtpërdrejt ose tërthorazi pavarësinë e gjyqtarëve dhe magjistratëve.

## **2. TRENDET**



### **Tribunalet ndërkombëtare**

Pas krimeve në Ruandë dhe ish-Jugosllavi, bashkësisë ndërkombëtare i'u desh të reagojë dhe të themelojë dy tribunale *ad hoc*, për të filluar procedurat ndjekëse dhe për t'i gjykuar krimet më serioze që u kryen gjatë këtyre luftërave dhe konflikteve të armatosura. Edhe pse deri më tani këto tribunale kanë bërë një punë bukur të suksesshme, ato janë kritikuar për arsye të ndryshme: ka pasur pretendime se janë gjykata ilegale, janë kritikuar për pasiguri lidhur me rregullat e procedurës (pasiqë gjyqtarët mund t'i ndërrojnë ato

varësisht prej nevojave të tyre), për mosekzistim të kompensimit për të akuzuarit gabimisht dhe për qëndrim të përgjithshëm ndaj parashtresve që shihen si “*të këqinj të e mëdhenj para gjyqit*”. Dukë nxjerrë mësim nga këto të meta, bashkësia ndërkombëtare iu qas në mënyrë të ndryshme themelimit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale (ICC). Më shumë përgjegjësi janë lënë në shtetet palë të Statutit të Romës dhe janë bërë përpjekje për forcimin e sundimit të ligjit.

### **Ndërmjetësimi dhe arbitrazhi**

Shtetet janë duke u angazhuar gjithnjë e më shumë në procedurat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (ndërmjetësim dhe arbitrazh), duke i lehtësuar gjykatat dhe duke shkurtuar kështu procedurat gjyqësore, por gjithashtu tentojnë që duke gjetur zgjidhje të pranueshme për të dyja palët, të krijohen situatat e njohura si “*fitues-fitues*”. Në veçanti, gjyqet e SHBA-ve janë vazhdimisht të paafta që të merren me numrin e madh të kërkesave brenda kohës së caktuar, deri sa në Evropë ky aspekt nuk paraqet problem.

Deri sa procedurat gjyqësore kanë qëllim trajtimin e kërkesave ligjore, ndërmjetësimi gjithashtu merr parasysh nevojat dhe interesat e individëve dhe kështu sjell rezultate më të mira në çështjet siç janë biznesi, marrëdhëniet familjare dhe ato fqinjësore.

**Ndërmjetësimi** është metodë e zgjidhjes së grindjes mes palëve me udhëzimin ose ndërmjetësimin e palës së tretë. **Arbitrazhi** është formë e zgjidhjes së grindjes në bazë të vendimit të një arbitri, i cili është i detyrueshëm për palët.

Shume shtete parashohin ndërmjetësim të obligueshëm gjatë fazave paraprake. Nevoja për gjykim del vetëm atëherë kur ndërmjetësimi nuk çon te një zgjidhje. Për shembull, në SHBA dhe Australi, mbahen periodikisht të ashtuquajturat “*javë të pajtimit*”, ku ndërmjetësohen të gjitha rastet e lidhura me gjyqin. Dhe, në të vërtetë, një numër i madh i rasteve zgjidhen në mënyrë të suksesshme (për shembull, 70% në shtetin e Ohajos). Por, përsëri dikush mund të argumentojë se palëve u është mohuar qasja në gjykatë, pasi që alternativat për procedura të gjata dhe të shtrenjta gjyqësore, mund të ushtrojnë presion të theksuar mbi palët për të gjetur një zgjidhje.

### **Rritja e publicitetit të gjykimeve**

Gjatë viteve të fundit është rritur popullaritetit i “televizionit të vërtetë (ose real)”. Gati se gjithçka mund të shihet në televizion, duke filluar nga ndjekja e veturave, programet e mbijetimit, e deri te jeta e përditshme e disa njerëzve brenda një shtëpie. Në këtë shumëllojshëmri të jashtëzakonshme, programet e bazuara në dhomat e gjykatave kanë gjetur gjithashtu një numër të madh të adhuruesve. Pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për gjykime të vërteta ose drama televizive, tani mund të shikohet drejtësia nga krevati, duke pirrë një birrë të ftohtë dhe duke ngrënë kikirikë. Kjo natyrisht së zgjon disa kritika të natyrës morale. Deri sa në njërin anë, publicitetit i gjykimit është qendror për gjykim të drejtë, në anën tjetër, kjo formë e prezantimit ka të bëjë shumë pak me shfaqjen e drejtësisë në mënyrë të drejtë, por më shumë ka të bëjë me kërkesën e pastër për senzacion dhe lojë me emocionet afatshkurtra të shikuesve. Strategjitë kundërpërgjigjëse më adekuate ndaj këtyre programeve janë udhëzuesit etikë, të zhvilluar nga organizatat dhe asociacionet e gjyqtarëve.

### **3. KRONOLOGJIA**

**1948:** Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

**1950:** Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

**1966:** Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

**1969:** Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut

**1982:** Raportuesi Special i OKB-së për Ekzekutime të Paligjshme dhe Jashtëprocedurale

**1984:** Komenti i Përgjithshëm Nr. 13 i Nenin 14 të ICCPR-it

**1985:** Parimet Themelore të OKB-së për Pavarësinë e Gjyqësisë

**1986:** Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve

**1990:** Parimet Themelore të OKB-së për Rolin e Avokatëve

**1991:** Grupi Punues i OKB-së për Arestime Arbitrare

**1994:** Raportuesi Special i OKB-së për Pavarësinë e Gjyqtarëve dhe Avokatëve

**1998:** Statuti i Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale

### **AKTIVITETE TË PËRZGJEDHURA**



**1**

**AKTIVITETI I: TË JESH OSE TË MOS JESH I DËGJUAR?**

**PJESA I: HYRJE**

Ky aktivitet është luajtje e roleve dhe ka për qëllim demonstrimin e rregullave të procedurave të gjyqimit.

**Forma e aktivitetit:** Luajtje e roleve

## **PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR AKTIVITETIN**

**Qëllimet dhe Synimet:**

- Përjetimi i përvojës nga dhoma e gjyqit.
- Identifikimi i përkufizimit të gjyqimit publik të drejtë.
- Zhvillimi i aftësive analizuuese.

**Grupi i synuar:** të rriturit e rinj dhe të rriturit

**Madhësia e grupit/organizimi shoqëror:** 15 – 20

**Kohëzgjatja:** rreth 90 minuta

**Përgatitja:**

Rregullojeni klasën si një dhomë të gjyqit. Një tavolinë vendoset përpara për gjyqtarin dhe dy të tjera në këndet anësore të tij, njëra përballë tjetrës - një për të akuzuarin dhe mbrojtësin dhe tjetra për ekipin e prokurorisë.

**Aftësitë e përfshira:**

Mendim kritik dhe aftësi analizuuese, komunikim, ndërtim i opinioneve, aftësi për vetidentifikim me situatën.

## **PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE PËR LUAJTJEN E ROLEVE**

**Hyrje:**

Shpjegoni se do të luani rolin e gjyqit me dy skenarë të ndryshëm, një pa mbrojtje dhe tjetrin me mekanizma mbrojtëse. Shpjegoni rolet dhe lejo pjesëmarrësit të zgjedhin rolet e tyre.

- Njëri person është i akuzuari gabimisht për një vepër penale, si vjedhja ose plaçkitja.
- Ekipi prej dy ose tre personash e udhëheqin ndjekjen (prokuroria).
- Një grup prej tre ose katër personash ngrisin aktakuzën dhe i shënojnë pikat e aktakuzës në tabelë.
- Një gjyqtar.

Akuzuesit dhe grupi që ngrit aktakuzën kanë dhjetë minuta për të përgatitur deklaratën akuzuese.

### **Shfaqja e luajtjes së roleve**

Në skenarin e parë, nuk ka avokat mbrojtës dhe i akuzuari nuk mund të mbrohet vetë. Pjesëmarrësit e tjerë janë vetëm audiencë në gjyq. Askujt në klasë nuk i lejohej të shprehë mendimin me zë. Kërko nga akuzuesit ta paraqesin rastin e tyre para gjyqtarit dhe nga gjyqtari që të marrë vendim, duke u bazuar vetëm në atë.

Pas kësaj, për skenarin e dytë, cakto një gjyqtar të ri për të dhënë aktgjykimin përfundimtar mbi fajësinë ose pafajësinë. Gjithashtu cakto një ekip mbrojtës prej dy ose tre personave. Lejo të akuzuarin të flasë dhe ekipin mbrojtës ta bëjnë deklarinimin e tyre. Audiencia është e lejuar që gjithashtu ta shprehë mendimin e vet. Vetëm pas kësaj, gjyqtari i ri duhet ta sjellë vendimin.

### **Vlerësimi**

Mblidh sërish të gjithë pjesëmarrësit. Së pari pyeti ata që kanë marrë pjesë në luajtjen e roleve:

- Sa ka qenë e mundur të ndikohet vendimi i gjyqtarit?
- Sa ka qenë simulimi real?

Pastaj, mundohu ta motivosh gjithë grupin të mendojë për procesin dhe qëllimin e dy shfaqjeve.

- Çka ishte ndryshe te këto dy skenare dhe pse?
- A janë ndier pjesëmarrësit keq gjatë skenarit të parë?
- A është e mundur që skenarët si ai i pari mund të ndodhin në jetën e vërtetë?

### **Këshilla praktike**

Provo që para se të fillosh shfaqjen të mos e shpjegosh gjithë poentën e luajtjes së roleve. Vlerat befasuese mund të kenë ndikim më të madh te pjesëmarrësit dhe gjithashtu nuk do të pengohet shfaqja e luajtjes së roleve. Qëndro i kujdesshëm gjatë shfaqjes, e posaçërisht në të parën dhe ndërhyjë nëse i akuzuari fillon të ndiejë nervozë ose frikë. Kjo nuk do të thotë se aktivitetit dështoi, por sa i vërtetë mund të jetë simulimi.

### **Sygjerime për ndryshim**

Për skenarin e dytë në vend të një gjyqtari mund të caktoni një juri prej tre ose katër personave. Gjatë vlerësimit, bisedoni për dallimet mes një gjyqtari dhe jurisë.

### **PJESA IV: VAZHDIMI**

Lexo Nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR).

*“Çdokush ka të drejtë për barazi të plotë, për gjykim të drejtë dhe publik, para gjyqit të paanshëm e të pavarur që do të vendosë për të drejtat dhe obligimet e tij/saj dhe për mbështetshmërinë e çdo akuze penale kundër tij/saj.”*

Shpjego me fjalë të tjera se, kjo do të thotë që nëse del në gjykim, gjykimi duhet të jetë publik. Dëgjimi publik është ai kur i akuzari është i pranishëm në gjykim dhe provat parashtrihen para tij si dhe para familjes së tij dhe komunitetit.

Njerëzit që gjykojnë të akuzuarin nuk duhet t'i lejojnë vetes që të ndikohen nga të tjerët. Varësisht prej roleve të luajtura, diskuto faktin se çdokush duhet ta ketë të drejtën dhe rastin për ta prezantuar rastin e vet. Kjo vlen si në rastet penale edhe ato mosmarrëveshje civile, ku një person akuzon tjetrin.

U trego pjesëmarrësve definicionin e OKB-së, se çka e bënë një gjykatë të pavarur dhe të paanshme: i `pavarur` dhe i `paanshëm` do të thotë se gjyqi duhet të gjykojë çdo rast drejt dhe në bazë të provave dhe se për shkaqe politike sundimi i ligjit nuk duhet të favorizojë asnjërën palë të rastit.

### **Të drejtat e ngjashme / fushat tjera të hulumtimit:**

Prezumimi i pafajësisë, njohja si person para ligjit, e drejta në mbrojtës të aftë; elementet e demokracisë

**BURIMI:** MARRË NGA: UNITED NATIONS CYBERSCHOOLBUS; AVAILABLE ONLINE AT:

[HTTP://WWW.UN.ORG/CYBERSCHOOLBUS/HUMANRIGHTSDECLARATION/10.ASP](http://www.un.org/cyberschoolbus/humanrightsdeclaration/10.asp), FEBUARY 2003



### **AKTIVITETI II: “SI MUND T’I MBROSH ATA NJERËZ?”**

## **PJESA I: HYRJE**

Ky aktivitet është diskutim i bazuar në raste e vërteta me qëllim të identifikimit të paragjytimeve dhe definicionit përkatës të gjykimit të drejtë.

**Forma e aktivitetit:** Diskutim

## **PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR DISKUTIMIN**

### **Qëllimet dhe Synimet:**

- Identifikimi i paragjytimeve dhe kufizimeve të vështrimeve neutrale
- Zhvillimi i aftësive analizuese.

**Grupi i synaur:** të rriturit e rinj dhe të rriturit

**Madhësia e grupit/organizimi shoqëror:** 15 – 20

**Kohëzgjatja:** rreth 60 minuta

**Materiali:** Materiali për t'u shpërndarë (shiko më poshtë)

### **Përgatitja**

Përgatit për të shpërndarë një deklaratë të avokatit mbrojtës Geri Spens (Gerry Spence) – shiko më poshtë.

### **Aftësitë e përfshira:**

Mendimi kritik dhe aftësi analizuese, aftësi komunikuese, ndërtim i opinionëve, shprehje e mendimeve dhe pikëpamjeve të ndryshme për problemin.

## **PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE PËR DISKUTIMIN:**

Duke u lejuar pjesëmarrësve t'i paramendojnë kryesit e krimeve që ata i njohin (ose ua trego një videokasetë të ndonjërit prej tyre), bëhet paraqitja e temës. Nëse dëshirohet, ata mund të shënohen në tablë ose në letër të madhe.

Pastaj pjesëmarrësit lejohen të paramendojnë se janë mbrojtës të klientëve të akuzuar për krime të mëdha.

Shpërndahet deklarata e avokatit mbrojtës Geri Spens, i cili përshkruan përgjigjen e tij pyetjes që shepsh i bëhet atij, “Si mund t'i mbrosh ata njerëz?”

Pastaj fillon diskutimi për të drejtat e kryesve në bazë të kësaj deklarate.

- A duhet të konsiderohet secili i pafajshëm deri sa nuk provohet se është fajtor?
- Nëse akuzohesh për krime, a do të duhej që ta kishte gjithnjë të drejtën për ta mbrojtur veten?
- A i duhet lejuar çdokujt të kërkojë ndihmë ligjore dhe ta ketë atë ndihmë pa pagesë nëse ai/ajo nuk kanë mjete për ta siguruar një?
- A duhet të jenë të gjithë të barabartë para ligjit?

Nëse dëshirohet, për ta përfunduar diskutimin në tabelë, mund të shkruhen disa argumente.

### **Vlerësimi:**

Gjatë kohës së vlerësimit, nga pjesëmarrësit kërkohet vetëm ta përmbledhin diskutimin në pika të shkurtra:

- Çka mendojnë pjesëmarrësit, pse avokatët mbrojnë kriminelët?
- A mendojnë ata se këta avokatë shihen njëjtë sikurse kriminelët të cilët ata i mbrojnë dhe pse është ashtu?

### **Këshilla praktike:**

Tema mund të paraqitet duke e lëshuar një videokasetë ose duke lexuar një artikull për kriminelët e mëdhenj, siç janë ata nga koha e nacistëve, Ku Klux Klanit në SHBA dhe diktatorëve të Amerikës Latine ose Azisë. Gjithashtu mund të referohen rrethanat lokale dhe aktuale dhe të bisedohet për njerëzit që akuzohen nga populli për kryerjen e krimeve të rënda. Nëse bëhet kjo, duhet pasur kujdes ndaj emocioneve që mund të shkaktojë ky debat. Mendimet e pjesëmarrësve nuk bënë të gjykohen, por duhet theksuar qartë se të drejtat e njeriut janë për të gjithë dhe se ato nuk mund të derogohen në mënyrë arbitrare në asnjë moment.

### **Sygerime për ndryshim:**

Mund të diskutohet Neni 11 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR). Ky nen shkruhet në tabelë dhe shpjegohet kuptimi dhe qëllimi i tij. Duhet të konsiderohesh i pafajshëm deri sa nuk provohet fajësia jote. Nëse je i akuzuar për krim, gjithmonë duhet të kesh të drejtë për ta mbrojtur veten. Askush nuk ka të drejtë të të akuzojë ose dënojë për një vepër të cilën nuk e ke kryer. Prezumimi i pafajësisë dhe e drejta për mbrojtës

janë dy parime të rëndësishme të theksuara në këtë dispozitë. Në lidhje me këtë mund të bëhet vazhdimi i aktivitetit “të jesh ose të mos jesh i dëgjuar?”.

#### **PJESA IV: VAZHDIMI**

Nenet 6 dhe 8 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR) duhet të lexohen me zë.

Neni 6: “Çdokush ka të drejtë të pranohet si subjekt para ligjit”. Duhet shpjeguar se kjo do të thotë se ke të drejtë që të mbrohesh ligjërisht gjithkund njësoj dhe njëjtë si çdokush tjetër. Definicioni: personi para ligjit është dikush që pranohet si subjekt i mbrojtjes së ofruar nga sistemi ligjor dhe përgjegjësive të kërkuara nga ai sistem.

Neni 8: “Çdokush ka të drejtë që me mjete juridike efektive të mbrohet para gjykatave kompetente kombëtare nga veprimet e shkeljes së të drejtave themelore të garantuara me kushteutë ose me ligj”. Kjo do të thotë se të lejohet të kërkohë ndihmë juridike, kur të drejtat tua nuk respektohen.

**BURIMI:** MARRË NGA: “CORRESPONDENCE BIAS IN EVERYDAY LIFE”, CARLETON COLLEGE, MINNESOTA, USA, AVAILABLE AT: [HTTP://CARLETON.EDU/CURRICULAR/](http://CARLETON.EDU/CURRICULAR/)

#### **Teksti që shpërndahe:**

“Si mund t’i mbrosh ata njerëz?”

Geri Spence (Gerry Spence), avokat mbrojtës:

*“A mendoni se i akuzuari duhet të gjykohet para se ta varim atë? Nëse po, atëherë a duhet që ai gjykim të jetë i drejtë? Nëse duhet të jetë i drejtë, a duhet që i akuzuari të ketë avokat? Nëse duhet t’i lejohet avokati, a duhet që ai avokat të jetë i aftë? Pastaj, nëse avokati mbrojtës e di se i akuzuari është fajtor, a duhet ai të bëjë gjithçka gjë që ta humbë rastin? Nëse jo, a duhet që ai të bëjë çdo gjë në mundësitë e tij për ta dëshmuar rastin përtej dyshimit të bazuar? Dhe nëse ai bën çdo gjë dhe prokuroria dëshmon ta dëshmojë rastin përtej dyshimit të bazuar dhe nëse juria e liron të akuzuarin nga fajësia, kë e fajësoni ju? A e fajësoni avokatin mbrojtës, i cili ka bërë punën e tij, apo prokurorin i cili nuk e ka bërë punën e tij?”*

**BURIMI:** MARRË NGA HARPER’S MAGAZINE, JULY 1997

## **BIBLIOGRAFIA**

**Amnesty International. 2001.** *Egypt- Trials of Civilians Before Military Courts Violate Human Rights Standards*. Available online at:

<http://www.amnestyusa.org/2001/egypt11102001.html>

**Becker, Michael, Hans-Joachim Lauth and Gert Pickel. 2001.** *Rechtsstaat und Demokratie. Theoretische und empirische Studien zum Recht in der Demokratie*. Wiesbaden: Westdeutscher Verlag.

**Bell, Ryand Brett and Paula Odysseos. 2002.** *Sex, Drugs and Court TV? How America's Increasing Interest in Trial Publicity Impacts our Lawyers and Legal System*. 15 Georgetown Journal on Legal Ethics 653.

**Carothers, Thomas. 1998.** *The Rule of Law Revival*. Foreign Affairs, Vol. 77, Issue 2.

**Cotran, Eugene and Mai Yamani. 2000.** *The Rule of Law in the Middle East and the Islamic World, Human Rights and the Judicial Process*. New York: Palgrave.

**Goldfarb, Ronald. 1998.** *TV or not TV: Television, Justice and Courts*. New York: New York University Press.

**Hofmann, Rainer, Joseph Marko and Franz Merli, 1996.** *Rechtsstaatlichkeit in Europa*. Heidelberg: C.F. Müller.

**Lawyers Committee for Human Rights. 2000.** *What is a fair trial? A basic Guide to Legal Standards and Practice*. Available online at:

[http://www.lchr.org/pubs/descriptions/fair\\_trial.pdf](http://www.lchr.org/pubs/descriptions/fair_trial.pdf)

**Huber, Martina. 2002.** *Monitoring the Rule of Law, Consolidated Framework and Report*, The Hague: Netherlands Institute of International Relation.

**Robinson, Mary. 1998.** *Opening Speech, Building Justice: A Conference on Establishing the Rule of Law in Post-Conflict Situations*. Vienna 26-27 June 1998.

**Office of the High Commissioner for Human Rights. 1985.** *Basic Principles on the Independence of the Judiciary.* Adopted by the Seventh United Nations Congress on the Prevention of Crime and the Treatment of Offenders held at Milan from August to 6 September 1985 and endorsed by General Assembly resolutions 40/32 of 29 November 1985 and 4/146 of 13 December 1985. Available online at:  
[http://193.194.138.190/html/menu3/b/h\\_comp50.htm](http://193.194.138.190/html/menu3/b/h_comp50.htm)

**Ramen, Frank. 2001.** *The Rights of the Accused (Individual Rights and Civic Responsibility).* New York: The Rosen Publishing Group.

**Weissbrodt, David A. 2001.** *The Right to a Fair Trial under the Universal Declaration of Human Rights and the International Covenant on Civil and Political Rights, Articles 8, 10, and 11 of the Universal Declaration on Human Rights.* The Hague: Kluwer Academic Publishers.

**Wissbrodt, David and Rüdiger Eölftrum. 1997.** *The Right to a Fair Trial.* Berlin: Springer Verlag.

**INFORMATA PLOTËSUESE:**

**The International Commission of Jurists' Center for the Independence of Judges and Lawyers:** [http://www.icj.org/rubrique.php?id\\_rubrique=40&lang=en](http://www.icj.org/rubrique.php?id_rubrique=40&lang=en)

**The COE Venice Commission:** <http://www.venice.coe.int/site/interface/english.htm>

**Inter-American Network for Human Rights and Development:**

<http://www.oneworld.org/afronet/afronet.htm>

**The Rights Consortium:** <http://www.rightsconsortium.org>

**The Asia Foundation:** <http://www.asiafoundation.org/programs/legal-reform.html>

**Shah, Nasim Hasan. 1994.** *Judgement on the Constitution, Rule of Law, and Martial Law in Pakistan.* Pakistan: OUP

All Africa Com: <http://allafrica.com>

**Center of Islamic and Middle East Law (CIMEL):**

<http://www.soas.ac.uk/Centers/IslamicLaw/>